



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSIEDA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 5308 Nr. i faq./Br.str./No.pg 33
Data/Date 18/02/25

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në bazë të neneve 23 dhe 24 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, si dhe nenit 31 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, kryetari i Komunës, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, bën:

NJOFTIMIN

PËR

TAKIM PUBLIK KONSULTATIV ME QYTETARË

Njoftohen të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit, grupet e interesit dhe palët e tjera të interesuara që Kuvendi i Komunës në Rahovec, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.11.2024, ka marrë vendim për shfuqizimin e rekomandimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, respektivisht **hotel "Park Plaza"** në Rahovec. Pas vendimit të Kuvendit, kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi, ka marrë vendim për shkëputje të kontratës me nr. prot. 2099, të datës 24.5.2013, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe aneks-kontrata me Nr. Prot. 02/150, e datës 10.2.2023, mbi kontratën bazë me Nr. Prot. 2099, të datës 24.5.2013.

Andaj, për të vendosur bashkërisht për fatin e hotel "Park Plaza", të cilit i është shkëputur kontrata për veprim, kryetari i Komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi, në bashkëpunim me Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, organizojnë takim publik konsultativ me qytetarë.

Takimi publik konsultativ me qytetarë do të mbahet më datë: **25.2.2025 (e martë), në orën 10:30**, në sallën e Kuvendit Komunal në Rahovec.

Jeni të mirëpritur!

